



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI I SHQIPËRISË
KOMISIONI PËR EKONOMINË DHE FINANCAT**

Tiranë, më 11.9.2018

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9831,
DATË 12.11.2007, “PËR DËMSPËRBLIMIN E ISH-TË DËNUARVE POLITIKË TË
REGJIMIT KOMUNIST”, TË NDRYSHUAR”**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 11 shtator 2018, shqyrtoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e Komisionit përgjegjës, sipas procedurave të parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit. Ky projektligj shqyrtohet me procedurë të përshpejtuar, mbështetur në nenin 28 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm, për të paraqitur projektligjin dhe për të dhënë sqarimet përkatëse, Ministri i Financave dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Projektligji synon përmirësimin e formulës së dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist, për të siguruar një mbështetje më të mirë financiare për personat që kanë vuajtur dënimin dhe janë ende në jetë apo për familjarët e tyre, si dhe për të përshpejtuar e përfunduar sa më parë këtë proces.

Ky projektligj synon të realizojë një ndër objektivat e Programit të Qeverisë, i cili i kushton një vëmendje të veçantë të përndjekurve politikë dhe familjeve të tyre, si dhe mbështet integrimin dhe pjesëmarrjen e tyre në çështjet shoqërore, ekonomike e politike. Buxheti i vitit 2018 siguron mbështetjen e nevojshme financiare për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë.

Projektligji parashikon këto ndryshime në ligjin ekzistues:

- **Së pari**, rishikohet mekanizmi i shpërndarjes së fondeve, duke i dhënë prioritet likuidimit të plotë të ish të dënuarve politikë që janë ende në jetë dhe subjekteve të tjera të kategorisë parësore. Sipas ligjit ekzistues, masa e dëmshpërblimit ndahet, në mënyrë proporcionale, në një raport prej 70 për qind për subjektet përfituese parësore (bashkëshorti dhe fëmijët) dhe 30 për qind për trashëgimtarët e tjerë (prindërit, vëllezërit e motrat dhe fëmijët e tyre). Familjarët në shkallë të parë përjashtojnë familjarët e tjerë. Projektligji e heq këtë raport dhe parashikon që dëmshpërblimi të ndahet në mënyrë proporcionale midis të gjithë përfituesve. Gjithashtu, në ligjin ekzistues theksohet se kësti i dëmshpërblimit duhet të jetë jo më i vogël se 100 mijë lekë dhe jo më i madh se 1 milionë lekë. Projektligji heq kufirin e poshtëm prej 100 mijë lekësh. Dëmshpërblimi për subjektet parësore është realizuar në masën 90 për qind dhe mbetet një diferencë e vogël e palikuiduar. Masat që propozohen me këtë projektligj do të sjellin ritme më të shpejta të shpërndarjes së dëmshpërblimit dhe përmbylljes së këtij procesi.
- **Së dyti**, krijohet mundësia që të gjitha subjektet përfituese parësore, të cilave u takon një vlerë totale dëmshpërblimi mbi 8 milionë lekë, ta përfitojnë të gjithë shumën e dëmshpërblimit. Sipas ligjit ekzistues, këtyre subjekteve u kufizohet dëmshpërblimi deri në 8 milionë lekë (8 kështe * 1 milionë lekë). Projektligji parashikon vijimin e shpërndarjes në kështe të dëmshpërblimit, deri në shpërndarjen e plotë të tij.
- **Së treti**, krijohet mundësia që kur vlera totale e dëmshpërblimit, e miratuar për të gjithë përfituesit, është 1 milionë lekë, shpërndarja e dëmshpërblimit të kryhet e plotë, me 1 kësht të vetëm.
- **Së katërti**, dëmshpërblimi financiar ndërpritet me mbylljen e rrethit të familjarëve që nuk jetojnë. Në këtë rast, duke qenë se dëmshpërblimi është e drejtë pasurore jovetiake dhe nuk zbatohen dispozitat e Kodit Civil, masa e dëmshpërblimit derdhet në buxhetin e shtetit. Ky rregullim ligjor qartëson procesin e dëmshpërblimit dhe ndikon në përdorimin me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, që është edhe një ndër parimet e menaxhimit të sistemit buxhetor.
- **Së pesti**, krijohet mundësia që, në raste gabimesh në llogaritjen e masës së dëmshpërblimit, të bëhen korrigjimet e nevojshme nga Këshilli i Ministrave.

Projektligji nuk sjell efekte financiare në buxhetin e shtetit.

Vlerësimi për projektligjin.

Komisioni është i mendimit se masat e propozuara me këtë projektligj do të ndihmojnë në përfitimin më të shpejtë e më të plotë të dëmshpërblimit financiar për ish të dënuarit politikë, duke i dhënë përparësi personave që kanë vuajtur dënimin dhe që janë ende në jetë, si dhe përfituesve të tjerë të kategorisë parësore. Këto masa janë ndërmarrë për të vënë në zbatim objektivat e programit qeveritar dhe detyrimet e përcaktuara në ligjin e buxhetit 2018.

Përfundim.

Mbështetur në argumentet e mësipërme, Komisioni e miratoi projektligjin me të gjitha votat e deputetëve të pranishëm në mbledhje.

RELATORE**Evis KUSHI****KRYETARI****Erion BRAÇE**